



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:099259
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05520622

PAKR.nr.49/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra - kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit K. V për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar E. Z, av. Arbër J. Fazliu dhe mbrojtësit të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.68/2019 i datës 19.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 06.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar E. Z, av. Arbër J. Fazliu dhe mbrojtësit të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.68/2019 i datës 19.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin P.nr.68/2019 të datës 19.12.2023, të akuzuarin K. V për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje tri (3) vite, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në këtë dënim të shqiptuar do të i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak nga dt. 03.04.2019 deri me datën 26.07.2019, si dhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 22.11.2023 e derisa aktgjykimi të merr formën e prerë.

Është obliguar i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën tridhjetë euro (30 €), në emër të shpenzimeve procedurale për ekspertimin mjeko ligjor të paguaj shumën njëqindpesëdhjetë euro (150 €) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50.00 €), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari E. Z, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil pranë Gjykatës kompetente.

Është urdhëruar konfiskimi i përhershëm i sendit (thikës) së sekuestruar, nga i akuzuari K. V. Është udhëzuar që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimi, ky send (thika) të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimin lidhur me sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.68/2019 i datës 22.12.2023 sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj dënim me burg efektiv më të lartë.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar E. Z, av. Arbër J. Fazliu, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e tij në tërësi dhe ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.68/2019 i datës 22.12.2023, ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj një dënim më të lartë me burgim efektiv.

Mbrojtësi i të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.68/2019 i datës 19.12.2023, ashtu që të akuzuarit K. V të i shqiptojë një dënim më të butë, ndërsa ankesat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë e ushtruar kundër këtij aktgjykimi, të refuzohet si e pa bazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/L.nr.64/2024 e datës 31.01.2024 ka propozuar që të aprovohen si të bazuara ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ajo e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar E. Z, av. Arbër J. Fazliu, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.68/2019 i datës 19.12.2023 dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i lartë me burg efektiv. Ndërsa ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.68/2019 i datës 19.12.2023.

Gjykata e Apelit, caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë, i dëmtuari E. Z dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar E. Z, av. Arbër Fazliu i akuzuari K. V, mbrojtësi i të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi, ndërsa Prokurori i Prokurorisë së Apelit nuk prezantoi në seancë, ndonëse i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar E. Z, av. Arber Fazliu, në seancën e kolegjit deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së parashtruar kundër aktgjykimi të ankimuar lidhur me vendimin mbi dënimin. Duke propozuar që të akuzuarit të i shqiptohet një dënim më i lartë dhe mbetet pas ndjekjes penale dhe kërkesë pasurore juridike. I dëmtuari E. Z e ka mbështetur avokatin. Mbrojtësi i të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve dhe propozimit të paraqitur në ankesë. Konsideron se nuk është vlerësuar mjaftueshëm pranimi i fajësisë dhe fakti që i akuzuari në atë kohë ishte adoleshent dhe i papjekur. I njëjti ka shprehur keqardhje dhe pendesë për veprën e kryer dhe janë pajtuar me familjen e të dëmtuarit. Gjithashtu, konsideroj se efekti i dënimin të i akuzuari veç se është arritur. I akuzuari K. V ka deklaruar se e mbështet fjalën e mbrojtësit.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, t në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar E. Z, av. Arbër J. Fazliu dhe mbrojtësit të

akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

Prokurori pretendon se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit ka nxjerrë konkluzion të gabuar për shkak së dënimit e shqiptuar e konsideron mjaftë të butë dhe jo adekuat në krahasim me veprën penale të kryer, pasojat konkrete dhe rrezikshmërinë shoqërore të saj.

Sipas Prokurorit, Gjykata me rastin e matjes së lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit nuk ka vlerësuar drejtë rrethanat mbi matjen e dënimit sipas dispozitave ligjore, sepse e njëjta është dashur të i vlerësojë dhe të ua fal besimin më shumë rrethanave rënduese, posaçërisht shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit. Këtë argument Prokurori e mbështet në faktin se i akuzuari me dashje ka ndërmarrë veprimet e cekura si në aktakuzë, duke dëshiruar shkaktimin e pasojës së goditjes me shkop dhe me thikë në pjesën e barkut, ku ndodhen organet vitale me qëllim të privimit nga jeta të dëmtuarin. Madje, Prokurori shton se dashja e të akuzuarit ka vazhduar të qëndrojë, mirëpo i dëmtuari ka arritur të ikë, të hyj brenda në shtëpi dhe të mbyll derën.

Gjithashtu, Prokurori konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit nuk do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit dhe se i njëjti nuk do të ndikoj tek personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale të kësaj natyre apo të tjera.

Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar E. Z, av. Arber Fazliu

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, në ankesë konsideron se nëse merret parasysh përgjegjësia e të akuzuarit në rastin konkret, dënim i shqiptuar nuk është në përputhje me dënimin e shkaktuar. Sipas mbrojtjes kjo çështje penale nuk është trajtuar siç duhet me seriozitet pasi që deri më tani është e pa parë që të dënohet me këtë lloj lartësie të dënimit personi i cili kryen veprën penale tentim vrasje, në rrethanat se si e ka kryer i akuzuari dhe me lëndime të rënda trupore që kanë rezultuar me pasoja të përhershme për shëndetin e të dëmtuarit.

Tutje, pretendon se Gjykata e shkallës së parë nuk i ka trajtuar fare rrethanat rënduese si të kaluarën kriminale të akuzuarit, ikjen- shmangien e tij nga gjykimi duke ikur, sigurimin e prezencës së tij vetëm përmes procedurës së ekstradimit dhe shkallën e lartë të dashjes së tij për kryerjen e veprës penale me qëllim të privimit nga jeta të dëmtuarit. Ndërsa, sa i përket

rrethanave lehtësuese pretendon se të njëjtat nuk është dashur të kenë ndikim kaq të madh në shqiptimin e dënimit, pasi që sipas tij përveç pranimet të fajësisë, i akuzuari nuk ka plotësuar asnjë rrethanë tjetër lehtësuese.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi

Mbrojtësi konsideron se, ekzistojnë rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit të cilat arsyetojnë një dënim më të butë për të njëjtin dhe atë nën minimumin e paraparë ligjor. Sipas mbrojtjes, Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar sa duhet faktin se i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë po thuhet se i mituri, pra i moshës 18 vjeçare (madhor i ri), faktin se me dt. 22.04.2019 menjëherë pas ngjarjes kritike familjet kanë arritur pajtimin, e as faktin se i akuzuari që nga fillimi ka shprehur keqardhje dhe pendim si dhe ka premtuar se asnjëherë në të ardhmen nuk do bie ndesh me ligjin.

Ndërkaq, lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore të ushtruar kundër aktgjykimit të ankimuar, me të cilën ankesë propozohet shqiptimi i një dënimi më të ashpër, mbrojtja të njëjtën e konsideron si të pa arsyetuar dhe se rrethanat rënduese të cilat i ka paraqitur Prokuroria në ankesë, sipas mbrojtjes më tepër paraqesin elemente të drejtpërdrejta konstituive të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, sepse pa përmbushjen e këtyre elementeve nuk do të mund të flitej fare për vepër penale.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore meqë i akuzuar ka pranuar fajësinë). Prandaj, aktgjykimi u vlerësua vetëm lidhur me pretendimet ankimore Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar dhe mbrojtësit të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi, sa i përket vendimit mbi sanksionin penal.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vendimin mbi dënimin

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar dhe mbrojtësit të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halim janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, duke vlerësuar si rrethanë rënduese shkallën e lartë të dashjes të shprehur nga i akuzuari për shkak të një konflikti paraprak me të dëmtuarin, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij, mënyrën e kryerjes së veprës penale, që konsiston në shkuarjen e të akuzuarit tek shtëpia e të dëmtuarit në natën e ngjarjes pas një konflikt verbal me të dëmtuarin dhe sulmimin e të dëmtuarit me shkop dhe me thikë, shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore te i dëmtuari me pasoja të përhershme për shëndetin e tij, si dhe sjelljen e të akuzuarit para këtij rasti, sepse rezulton që ndaj të njëjtit janë iniciuar edhe tri raste të tjera penale. Ndërkaq, Gjykata e shkallës së parë si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar fakti se, i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës shumë të re, se nga koha e kryerjes së veprës penale e deri tani ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe kanë ndryshuar shumë rrethana në jetën personale dhe familjare të akuzuarit, se i akuzuari ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe familjes së tij, ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, se pas këtij rasti ka treguar sjellje të mira, nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale, me parë nuk ka qenë i dënuar, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelle të tilla si dhe nuk do të veproj më në kundërshtim me ligjin. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese është marrë për bazë dhe vlerësuar, pranimi i fajësisë nga i akuzuari. Andaj mbi bazën e këtyre rrethanave Gjykata e shkallës së parë konform nenit 75 par.1, nënpar. 1.1, 1.2 dhe 1.3 lidhur me nenin 76 par.1 nënpar. 1.2 të KPRK-së aplikoi institutin e zbutjes së dënimit nën minimumin e paraparë me ligj pasi që vepra penale ka mbetur në tentativë dhe i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke vendosur kështu si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit, si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa, pretendimet e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar dhe mbrojtësit të akuzuarit K. V, av. Mahmut Halimi, janë pretendime të pabazuara, pasi që në rastin konkret rrethanat rënduese të theksuara në ankesën e Prokurorit dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, të cilat sipas tyre janë bazë për shqiptimin e një dënimi më të lartë, si dhe rrethanat lehtësues të theksuara në ankesën e mbrojtjes, të cilat sipas mbrojtjes janë

bazë për shqiptimin e një dënimi me të butë, veç se kanë qenë objekt i vlerësimit të Gjykatës së shkallës së parë dhe si rezultat i tyre Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin përkatës nën minimumin e paraparë me KPRK. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitive të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.49/24, datë 06.03.2024

Praktikantja gjyqësore

Erna Stublla

Anëtarët e kolegjit

Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit

Beqir Kalludra

Zyhdi Haziri